



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

Numri i lëndës: 2019:090701

Datë: 29.10.2020

Numri i dokumentit: 01226146

PKR.nr.1029/13

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-Departamenti për Krime të Rënda, në trupin gjykues të përbërë nga gjyqtari Beqir Kalludra kryetar i trupit gjykues, dhe gjyqtarët profesionistë Vesel Ismajli dhe Violeta Namani, anëtarë të trupit gjykues, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtorit profesional Driton Berisha, në çështjen penale kundër të akuzuarve H.S., R.E., S.G., M.B., E.M., A.N., dhe G.D., për shkak të veprës penale Mashtrimi në votime, nga neni 180 lidhur me nenin 23 të KPK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prishtinë-Departamenti për Krime të Rënda PP.nr.1372-13/2011, të dt.29.04.2011, pas përfundimit të shqyrtimit gjyqësor me dt. 18.09.2020, në prezencën e prokurores së shtetit Besa Limani, të akuzuarve R.E., M.B., dhe mbrojtësi av. L.V., E.M., dhe G.D., me dt. 18.09.2020 mori dhe të njëjtën ditë shpalli publikisht, derisa me date 07.10.2020 përpiloj këtë:

A K T G J Y K I M

Të akuzuarit :

R.E., nga i ati Q., dhe nëna N., i lindur më *data e lindjes...*, në fshatin K., Komuna e D., ku edhe tani jeton, i martuar, baba i 3 fëmije, ka të kryer shkollën e mesme, i gjendjes së dobët ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, me nr. të letërnjoftimit *numri i letërnjoftimit...*

M.B., nga i ati H., dhe nëna F., e vajzërisë D., e lindur më *data e lindjes...*, në fshatin V., komuna e D., ku edhe tani jeton, ka të kryer fakultetin e shkencave matematikore, e gjendjes së mesme ekonomike, e pa martuar, shqiptar, shtetase e Republikës së Kosovës, me nr. të letërnjoftimit *numri i letërnjoftimit...*

E.M., nga i ati A., dhe nëna H., e vajzërisë G., i lindur më *data e lindjes...*, në fshatin F. e U., tani me vendbanim në K., Komuna e D., i martuar, babë i 3 fëmijeve, ka të kryer shkollën e mesme, i gjendjes së dobët ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, me nr. të letërnjoftimit *numri i letërnjoftimit...*

G.D., nga i ati B., dhe nëna E., e vajzërisë Xh., i lindur më *data e lindjes...*, në S., tani me vendbanim në D., pas stacionit të trenit, i martuar, baba i 2 fëmije, ka të kryer shkollën e mesme, i gjendjes së dobët ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, me nr. të letërnjoftimit *numri i letërnjoftimit...*

JANË FAJTORË

Sepse:

Me dt.12.12.2010 gjatë mbajtjes së zhjedhjeve në Kuvendin e Republikës së Kosovës, në qendren e vendvotimit me nr.*numri i vendvotimit...*, në Shkollën Fillore "...", në fshatin K., Komuna e D., të akuzuarit në cilësinë e anëtarëve të këshillit të vendvotimit, kanë falsifikuar rezultatet e zgjedhjeve apo votimeve, duke shtuar, hequr apo shlyer votat a nënshkrimet, duke i numëruar në mënyrë jo të saktë rezultatet e zgjedhjeve në dokumente, edhe pse të gjithë i kishin të caktuar detyrat veç e veç, të njejtit gjatë ditës kishin ndërruar rolet në punë gjatë procesit zgjedhor, ashtu që paraprakishtë janë marrë vesh që secili të bëjë një numer të caktuar votash për subjektet politike të tyre, dhe pas mbylljes së vendvotimit të gjitha blloqet dhe fletëvotimet i kanë ndarë në mënyrë proporcionale, të cilat i kanë mbushur vet e pastaj i kanë vendos në kutitë e votimeve, ku përveq fletëvotimeve të rregullta, nuk i kanë kursyer as ato rezervë dhe asnjë fletëvotim nuk e kanë lënë pa e mbushur, dhe gjatë kësaj faze janë mbushur me nënshkrime fals mbi 300 rubrika të personave që nuk kanë votuar, të cilët gjenden jashtë shtetit, janë të sëmurë apo kanë vdekur, në mesin e të cilëve janë identifikuar si persona të vdekur M., dhe Z.B., A., H. dhe T.E., etj., e më pas kanë bërë numërimin e pa rregulltë të votave ku subjekti politik FER ka pasur një votë, ndërsa fare nuk është regjistruar në rezultatin përfundimtar, PDK kishte 605 vota, por të shumëzuara më 5 kanë dalur 3025 vota dmth 64 vota tepër, dhe si pasojë e këtyre veprimeve të ndaluara janë përsëritur zgjedhjet në atë vendvotim, me ç'rast buxhetiti te Republikës së Kosovë si kanë shkaktuar dëm të konsiderueshëm material.

- me këtë në bashkëkryerje kanë kryer veprën penale Mashtrimi në votime nga neni 180 lidhur me nenin 31 të KPK-së

Prandaj gjykata konform dispozitave 2, 3, 34, 42, 43 lidhur me 38, 64 dhe 180 par.1 të KPK-së, si dhe nenit 359, 365, 366, 368, 450 dhe 453 të KPPRK-së, i :

GJYKON

Të akuzuarit :

R.E., me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 3 (tre) muaj, i cili denim me pëlqimin e të akuzuarit do t'i shndërrohet në dënim me gjobë në shumën prej 100.00 eurove.

M.B. me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 3 (tre) muaj, i cili denim me pëlqimin e të akuzuarit do t'i shndërrohet në dënim me gjobë në shumën prej 100.00 eurove.

E.M., me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 3 (tre) muaj, i cili denim me pëlqimin e të akuzuarit do t'i shndërrohet në dënim me gjobë në shumën prej 100.00 eurove.

G.D., me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 3 (tre) muaj, i cili denim me pëlqimin e të akuzuarit do t'i shndërrohet në dënim me gjobë në shumën prej 100.00 eurove.

Detyrohen të akuzuarit që t'i paguajnë shpenzimet e procedurës penale, aq sa do të jenë sipas llogarisë përfundimtare të kësaj Gjykate, ndërsa shpenzimet e paushallit gjyqësor, secili veç e veç, shumën prej 20.00 (njëzetë) euro, brenda afatit prej 15 ditëve pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore – Departamenti për Krime të Rënda në Prishtinë, ka paraqitur aktakuzën PP.nr.1372-13/2011, të dt.29.04.2011, kundër të akuzuarve H.S., R.E., S.G., M.B., E.M., A.N. dhe G.D., për shkak të dyshimit se kanë kryer në bashkëkryerje veprën penale Mashtrimi në votime nga neni 180 lidhur me nenin 31 të KPK-së.

Lidhur me këtë çështje penale, Gjykata ka caktuar seancën e shqyrtimit gjyqësor në të cilën seancë është veçuar procedura penale kundër të akuzuarve H.S., S.G., dhe A.N., konfor nenit 36 par 1 të KPPRK-së, me që të njëjtit ishin të paarritshëm në kohën e mbajtjes së gjyqimit, procedura penale kundër të njëjtëve do të vazhdohet po sa të sigurohet prezenca e tyre në gjykatë, derisa seanca ka vazhduar me të akuzuarit R.E., M.B., E.M., dhe G.D., dhe pas leximit të aktakuzës, të gjithë të akuzuarit kanë deklaruar se e pranojnë fajësinë për kryerjen e kësaj vepre penale për të cilën janë akuzuar.

Meqë të akuzuarit R.E., M.B., E.M., dhe G.D., e kanë pranuar fajësinë në tërësi për kryerjen e veprës penale si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, pasi e kanë kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimi të fajësisë për kryerjen e veprës penale, pranimi i cili është bërë vullnetarisht, pranimi i cili mbështetet në faktet e çështjes dhe provat materiale që përmban aktakuza, dhe se nuk përmban asnjë shkelje ligjore apo gabim faktik, Gjykata vlerësoj se janë përmbushur të gjitha kërkesat ligjore nga neni 248 të KPPRK-së, që të pranohet deklarata e të akuzuarve për pranimin e fajësisë për kryerjen e kësaj vepre penale, dhe të njëjtën edhe e ka aprovuar, duke mos administruar asnjë provë lidhur me vërtetësinë e gjendjes faktike.

Ashtu që, bazuar në një gjendje të tillë të pa kontestuar të fakteve, gjykata vërtetoj se në veprimet e të akuzuarve R.E., M.B., E.M., dhe G.D., manifestohen të gjitha elementet qenësore të veprës penale Mashtrimi në votime nga neni 180 lidhur me nenin 31 të KPK-së, ashtu që të akuzuarit edhe i shpalli fajtorë, dhe ua shqiptoj sanksionet penale përkatëse, si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Prokurori i shtetit në fjalën përfundimtare ka deklaruar se meqenëse të akuzuarit e kanë pranuar fajësinë për veprën penale për të cilën akuzohen, dhe këtë pranim e ka aprovuar gjykata, dhe i ka propozuar gjykatës që si rrethanë lehtësuese të vlerësoj pranimin e fajësisë, si dhe rrethanat tjera t'i vlerësoj sipas detyrës zyrtare, dhe të njëjtit t'i shpall fajtorë dhe t'i gjykoj sipas ligjit.

I akuzuari R.E., i ka propozuar gjykatës që me rastin e shqiptimit të sanksionit penal, t'i vlerësoj rrethanat lehtësuese se i njëjti nuk ka qenë asnjëherë më parë i gjykuar, është mbajtës i familjes, baba i tre fëmijëve, i premtion gjykatës se nuk do të përsëris këto veprime, dhe e lut gjykatën që brenda mundësive ligjore t'ia shqiptoj një dënim sa më të butë të mundshëm ligjor.

Mbrojtësi i të akuzuarës M.B., av.L.V., në fjalën përfundimtare ka deklaruar se pas deklarimit nga e mbrojtura e tij për pranimin e fajësisë, ka kërkuar nga gjykata që me rastin e caktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit të ketë parasysht si rrethanë lehtësuese pranimin e fajësisë, kohën e gjatë që ka kaluar nga kryerja e kësaj vepre penale, mos përsëritja e veprave penale që nga ajo kohë, e njëjta është mbajtës e familjes, është e gjendjes së dobët ekonomike, dhe i premtion gjykatës se në të ardhmen nuk do t'i përsërisë veprime të tilla a të ngjajshme.

E akuzuara M.B., e ka mbështet fjalën përfundimtare të mbrojtësit të saj dhe e lut gjykatën që të ja shqiptoj një dënim sa më të butë.

I akuzuari E.M., po ashtu edhe njëherë e lutë gjykatën që të ia shqiptoj një dënim sa më të butë, duke i vlerësuar të gjitha rrethanat lehtësuese duke filluar nga pranimi i fajësisë, mos përsëritja asnjëherë e veprës penale, pendimi për këtë veprim dhe premtimi se nuk do të përsëriten këto lloje dhe veprime te tilla, se është i gjendjes jo të mirë ekonomike.

I akuzuari G.D., ka deklaruar se nisur nga fakti që ka pranuar fajësinë dhe asnjëherë më parë nuk ka rënë ndesh me ligjin, i premtun gjykatës se nuk do t'i përsëris veprime të tilla, se është i gjendjes jo të mirë ekonomike, dhe në fund ka kërkuar nga gjykata që ndaj të njëjtit t'i shqiptohet një dënim sa më i butë i mundshëm.

Gjykata me rastin e caktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit mori parasysh rrethanat relevante rënduese dhe lehtësuese, të parapara sipas nenit 64 të KPK-së, ku si rrethanë lehtësuese për të gjithë të akuzuarit mori pranimin e fajësisë, pendimin e thellë dhe keqardhjen për veprën penale të kryer, premtimin e të njëjtëve se në të ardhmen nuk do të përsërisin asnjëherë këto veprime, kohën e gjatë të kaluar nga koha e kryerjes së kësaj vepre penale, pastaj rrethanat e tjera personale se shumica e të njëjtëve janë mbajtës të familjeve dhe prindër të fëmijëve për të cilët duhet të kujdesen, dhe po ashtu edhe gjendjen ekonomike jo të mirë të tyre, e në mungesë të rrethanave rënduese, të akuzuarve ua shqiptoj sanksionin penal si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, me bindjen se një sanksion i tillë penal është në përputhje të plotë me shkallën e rrezikshmërisë shoqërore të kësaj vepre penale dhe përgjegjësinë penale të të akuzuarve, dhe se dënimi i shqiptuar do të ndikoj në riedukimin, risocializimin dhe parandalimin e të akuzuarve por edhe personave të tjerë nga kryerja e veprave penale në të ardhmen me çka edhe do të arrihet qëllimi i përgjithshëm dhe i veçantë i dënimit konform nenit 42 të KPK-së.

Vendimi lidhur me shpenzimet e procedurës penale kundër të akuzuarve, do të merret në bazë të llogarisë përfundimtare të kësaj gjykate, ndërkaq shpenzimet në emër të paushallit gjyqësor janë marrë, duke pasur për bazë ndërlikueshmërinë e veprës penale, kohëzgjatjen e zhvillimit të procedurës penale si dhe gjendjen pasurore të të akuzuarës, konform nenit 450 par.3 të KPRK-së.

Nga arsyet e cekura më lartë, e në pajtim me dispozitat ligjore nga neni 363 dhe 365 të KPPRK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË

Departamenti i Krimeve të Rënda
PKR.nr.1029/13, me dt.07.10.2020

Bashkëpunëtor profesional
Driton Berisha

Kryetari i trupit gjykues-gjyqtari
Beqir Kalludra

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa,
Gjykatës Apelit në Prishtinë, në afat prej 15 ditë,
nga dita e marrjes së të njëjtit, përmes kësaj gjykate.